



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë**

**Ministarstvo za Inovacije i Preduzetništvo – Ministry of Innovation and Entrepreneurship**

Nr. 77/2018

Datë: 03.10.2018

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, si dhe Rregulloren e MF - Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, z. Mentor Sylmeta, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Formohet komisioni për vlerësimin e projekteve të paraqitura në thirrjen publike të shpallur nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij vendimi, ka këtë përbërje:
  - 2.1. Arta Krasnqi, kryesuese;
  - 2.2. Blerta Maliqaj, anëtar;
  - 2.3. Esad Demaku, anëtar.
  - 2.4. Liridona Shkodra, anëtar i OJQ-ve;
  - 2.5. Agron Pajaziti, anëtar i Shoqërisë Civile;
  - 2.6. Lulzim Kadriu, anëtar rezervë i komisionit.
3. Komisioni punues nga pika 2 e këtij vendimi fillon punën menjëherë.
4. Komisioni është i mandatuar të bëjë vlerësimin e projekteve të paraqitura në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike dhe me Rregulloren e MF - Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
5. Komisioni punues nga pika 2 e këtij vendimi pas përfundimit të punës harton me shkrim Raportin përfundimtar për Zyrën Sekretarit të Përgjithshëm.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MIN-së.



**Mentor Sylmeta**  
**U.D. Sekretar i Përgjithshëm**